LIGJ
Nr. 15/2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9902, DATË 17.4.2008 "PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët "Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut" zëvendësohen me fjalët "Inspektorati përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut", ndërsa në nenin 57 zëvendësohen me fjalët "Inspektori i inspektoratit përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut" dhe emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë" zëvendësohet me emërtimin "Inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë".

Neni 2

Në nenin 51, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
"3. Kontrolli i respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".".

Neni 3

Në nenin 57, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:
"6. Gjobat e vendosura sipas këtij neni janë dënime kryesore.".

Neni 4

Nenit 58 i shtohet titulli "Gjobat e komisionit".

Neni 5

Pas nenit 58 shtohet neni 58/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 58/1
Shqyrtimi dhe ankimi i gjobave

Gjobat e vendosura nga inspektorët, sipas nenit 57 të këtij ligji, shqyrtohen, merren përfundimisht dhe ankimohen në përputhje me ligjin për inspektimin.".

Neni 6

Titulli i nenit 59 ndryshohet si më poshtë:

“Procedura e ankimit ndaj vendimeve të komisionit”.

Neni 7

Në nenin 59, pika 2 shfuqizohet.

Neni 8
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7974, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani